

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika MonoTop®-108 WaterPlug

LLAÇ ME NGURTËSIM TË SHPEJTË

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika MonoTop®-108 WaterPlug është llaç çimentoje me mpiksje të shpejtë për mbylljen e rrjedhjes së ujit në beton dhe mure.

PËRDORIMET

- Mbyllje e menjëhershme e presionit negativ të ujit nga rrjedhjet nëpërmjet plasaritjeve dhe fugave
- Mbyllje e menjëhershme e rrjedhjes së ujit të drenazhuar, gjatë trajtimeve për hidroizolim.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Ngurtësim i shpejtë për shmangien e "shpëlarjes" edhe prani uji të rrjedhshëm
- Ngurtësohet brenda ~ 60 - 80 sekondave (në 20 °C)

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Pluhur çimentoje me mpiksje të shpejtë
Ambalazhi	Qese alumini 5 kg të paketuara në kuti kartoni që përmban 4 copë
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur gri
Jetëgjatësia	15 muaj
Kushtet e magazinimit	Të magazinohet në mënyrën e duhur në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur në kushte të thata dhe të freskëta.
Dendësia	~1.1 kg/l

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	1.25–1.40 litra uji për qese 5 kg	
Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +30 °C max.	
Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +30 °C max.	
Koha fillestare e mpiksjes	Temperatura	Koha fillestare e ngurtësimit
	+5 °C	~120 sekonda
	+20 °C	~60 sekonda

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Pikat e hyrjes së ujit (plasaritjet, hapësirat midis zhavorrit, fugat, pikat e drenazimit) duhet të zgjerohen dhe thellohen me daltë, për të krijuar një sipërfaqe të përshtatshme për përmirësimin e ndërkapjes.

PËRZIERJA

Përzierjen shpejtë me dorë llaçin dhe ujin, në një sasi që është e mjaftueshme për të prodhuar material që aplikohet në pak sekonda. Mbroni duart me doreza gome. Koha e mpiksjes varion me ndryshimin e sasisë së ujit.

APLIKIMI

Vazhdoni përzierjen e miksit edhe për disa sekonda derisa të fillojë të mpikset, pastaj aplikojeni menjëherë. Shtypni llaçin tek pika e hyrjes së ujit dhe ushtroni presion të mjaftueshëm për disa sekonda derisa të jetë ngurtësuar plotësisht. Largoni materialin e tepruar me një shpatull pasi të ketë përfunduar mpiksja.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastrimi i mbetjeve të freskëta nga veglat dhe pajisja e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të largohet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Pas ngurtësimit, produkti nuk mund të punohet më
- Përzierjen vetëm atë sasi material që mund të aplikohet brenda pak sekondave
- Temperaturat e ulëta shkaktojnë zgjatjen e kohës së ngurtësimit, ndërsa temperaturat e larta shkurtojnë kohën e ngurtësimit
- Përdorni Sika MonoTop®-108 WaterPlug vetëm në prani rrjedhjesh uji. Për qëllime riparimi të betonit, përdorni një produkt të përshtatshëm nga seria SikaTop® ose Sika MonoTop®.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdo prej afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdo prej formave të tjera. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosítë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sika MonoTop®-108 WaterPlug
Shkurt 2019, Botimi 01.01
020701010010000284

SikaMonoTop-108WaterPlug-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf